

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE


NIPT L71710039A

Nr. 2138 Regj
Nr. 2100 Prot

Tiranë, më 19.12.2023

URDHËR
“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit
Adresa: Tirane
Per dijeni: “ARB & TRANS-2010” sh.p.k me Nipt L02325001T
Adresa: Blloku Gintash, 2 kateshet e Biznesit, Shkalla 2, Kati 2, Laprake, Tirane.
Per djeni: Inspektoriat i Mbrojtjes se Territorit, Bashkia Tirane
Adresa: Tirane



Unë, Eris Sotiri, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyres Permbarimore Private “REAL BAILIFF SERVICE”, në referim të Urdherit të Ekzekutimit “Vendimi Nr. 1638 Regj. Them date regj. 22.07.2022, date vendimi 15.09.2022, i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane”, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.2139, Datë 01.12.2023 kërkesën e kreditorit Inspektoriat i Mbrojtjes se Territorit, Bashkia Tirane ndaj debitorit “ARB & TRANS-2010” sh.p.k me Nipt L02325001T, në lidhje me titullin ekzekutiv “Vendim per denimin me gjobe Nr.4116 date 20.01.2022”, leshuar nga Inspektoriat i Mbrojtjes se Territorit.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr.1928 Prot, Datë 01.12.2023, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdheri i Ekzekutimit “Vendimi Nr. 1638 Regj. Them date regj. 22.07.2022, date vendimi 15.09.2022, i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane” në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA:

Debitori “ARB & TRANS-2010” sh.p.k me Nipt L02325001T, nuk i eshte përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të lajmërimit per ekzekutim vullnetar te detyrimit.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit “ARB & TRANS-2010” sh.p.k me Nipt L02325001T, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 527 e vijues te K.Pr.Civile, si dhe të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, me qellim ekzekutimin e titullit ekzekutiv,

URDHËROJ:

1. Qendra Kombetare e Biznesit, të vendose sekuestron konservative mbi aktivet e pales debitore “ARB & TRANS-2010” sh.p.k me Nipt L02325001T me qellim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE
PËRMBARUESI GJYQËSOR
ERIS SOTIRI